REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA AKSIONARE UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A SKRAPAR
**ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME E SHOQËRISË**
(AKSIONER I VETËM)

Nr. 1035 Prot. Skrapar më, 25 / 04 / 2023

**VENDIM**
**NR. 02 DATË 25 / 04 /2023**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË, SHPALLJEN E SAJ NË LIKUIDIM DHE EMERIMIN E LIKUIDATORIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, sot, më date 25 Prill 2023, Shoqeria Aksionare Ujësjellës Kanalizime Sh.a Skrapar, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J69102437J, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë zoti Sokol Çeçaj, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

**Çështjet e rendit të ditës:**

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim;
- Emërimi i Likuidatorit.

**Në shqyrtim të rendit te ditës, Asambleja vëren:**

Shoqeria Aksionare Ujësjellës Kanalizime Sh.a Skrapar nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr. 4769 Rep. dhe Nr. 2731 Kol, datë 15.11.2022 midis Shoqerisë Aksionare Ujësjellës Kanalizime Sh.a Skrapar dhe shoqërisë Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 1.1.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të prishet dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

**Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja**

**VENDOSI:**

1. Përfundimin e aktivitetit të Shoqerisë Aksionare Ujësjellës Kanalizime Sh.a Skrapar dhe prishjen e saj

2. Shoqeria Aksionare Ujësjellës Kanalizime Sh.a Skrapar shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
3. Emërimin e Z. Sokol Çeçaj si likuidator të Shooqërisë Aksionare Ujësjellës Kanalizime Sh.a Skrapar.
4. Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në perputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likudimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likudimin e shoqërisë.

Ky vendim hynë menjëherë në fuqi,

**KRYETARI I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME (AP)**

**Adriatik MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SKRAPAR